



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.202

dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 034 datë 22.12.2008	Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve.....	10929
Ligj nr.10 047 datë 24.12.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	10942
Ligj nr.10 048 datë 24.12.2008	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.7, datë 15.12.2008, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar”.....	10947
Ligj nr.10 049 datë 24.12.2008	Për një ndryshim në ligjin nr.7811, datë 12.4.1994 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.782, datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)”.....	10947
Ligj nr.10 050 datë 24.12.2008	Për një ndryshim në ligjin nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.....	10948

LIGJ
Nr.10 034, datë 22.12.2008

PËR PASTËRTINË E FIGURËS SË FUNKSIONARËVE TË LARTË
TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TË TË ZGJEDHURVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim të kontrollojë pastërtinë e figurës së çdo funksionari publik të zgjedhur apo të emëruar, lidhur me pjesëmarrjen e tij në strukturat politikëbërëse dhe zbatuese të dhunës së diktaturës së proletariatit, si edhe në strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit, për periudhën 29 nëntor 1944 deri më 8 dhjetor 1990.

Neni 2
Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i subjekteve dhe funksioneve të larta shtetërore, të cilat janë të papajtueshme me veprimtarinë publike të zyrtarit, për shkak të qenies anëtar, drejtues apo bashkëpunëtor në strukturat politikëbërëse dhe zbatuese të dhunës së diktaturës së proletariatit apo të ish-Sigurimit të Shtetit, për periudhën 29 nëntor 1944 deri më 8 dhjetor 1990, rastet e papajtueshmërisë, procedurat e verifikimit dhe pasojat e këtyre procedurave.

Neni 3
Subjektet e verifikimit

Subjekt i verifikimit, sipas këtij ligji, janë të gjithë funksionarët publikë, të zgjedhur apo të emëruar, të cilët aktualisht ushtrojnë apo do të ushtrojnë një nga funksionet e mëposhtme:

- a) Presidenti i Republikës së Shqipërisë;
- b) deputetët e Kuvendit të Shqipërisë;
- c) anëtarët e Këshillit të Ministrave, zëvendësministrat, funksionarët politikë, sekretarët e përgjithshëm, drejtorët e përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive të dikastereve, si dhe të barazuarit me ta në institucionet e tjera shtetërore qendrore ose të pavarura;

- c) anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe gjyqtarët e prokurorët pranë gjykatave dhe prokurorive të të gjitha niveleve;
- d) funksionarë të lartë të Presidencës, të administratës së Kuvendit, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese, të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas rangjeve të caktuara në shkronjën “c” të këtij neni;
- dh) guvernatorë, zëvendësguvernatorë dhe drejtorët e Bankës së Shqipërisë;
- e) funksionarë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, si dhe oficerët me gradë “Gjeneral” dhe “Kolonel”;
- ë) prefektët, kryetarët e këshillave të qarkut, si dhe kryetarët e bashkive dhe komunave;
- f) drejtuesit e drejtorive të administratës publike në nivel qarku;
- g) në Shërbimin Informativ Shtetëror (SHISH), në Shërbimin Informativ Usharak (SHIU) dhe në çdo shërbim tjetër inteligjent;
- gj) në Gardën e Republikës;
- h) funksione drejtuese në Policinë e Shtetit deri në nivel qarku dhe komisariati;
- i) drejtuesit e përfaqësive diplomatike;
- j) anëtarët e Akademisë së Shkencave, rektorët, zëvendësrektorët dhe dekanët në universitetet publike, si dhe drejtorët e gjimnazeve dhe shkollave të mesme tekniko-profesionale;
- k) Drejtori i Përgjithshëm, zëvendësdrejtorët e përgjithshëm, drejtori dhe zëvendësdrejtori i Radios, drejtori dhe zëvendësdrejtori i Televizionit dhe drejtorët e departamenteve në Radiotelevizionin Publik Shqiptar; drejtori, zëvendësdrejtori dhe drejtorët e departamenteve në ATSH, si dhe anëtarët e këshillave drejtues të medie publike;
- l) çdo person tjetër i dekretuar nga Presidenti i Republikës apo i zgjedhur nga Kuvendi.

Neni 4

Papajtueshmëria e funksioneve

Pastërtia e figurës morale të funksionarit publik, të përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji, është e papajtueshme me mbajtjen prej tij, gjatë periudhës 29 nëntor 1944 deri më 8 dhjetor 1990, të një prej detyrave/cilësive të mëposhtme:

- a) anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të PPSH-së, me përjashtim të rasteve kur ka vepruar kundër vijës zyrtare apo është larguar vetë nga detyra në mënyrë publike;
- b) anëtarët e Presidiumit të Kuvendit Popullor;
- c) Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm dhe Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme;
- c) Ministër, Zëvendësministër i Punëve të Brendshme dhe çdo punonjës i organeve të Sigurimit të Shtetit, si dhe kryetarët e degëve të punëve të brendshme;
- d) personat që kanë mbaruar shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme në profilin e Sigurimit, ose kanë kryer kurse tremujore e lart po në këtë profil, ose në analoget e tyre brenda apo jashtë shtetit dhe që kanë punuar si hetues, prokurorë apo gjyqtarë, pa qenë të diplomuar “jurist”;
- dh) i dënuar me vendim penal të formës së prerë për krime kundër njerëzimit ose për veprat penale të shpifjes, të kallëzimit të rremë ose dëshmisë së rreme në procese politike;

- e) bashkëpunëtor i organeve të Sigurimit të Shtetit me veprimtari të karakterit politik, që lidhen me veprat penale politike të parashikuara nga ligji nr.7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, i ndryshuar, apo bashkëpunëtor vullnetar për vepra të tilla;
- ë) anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-Internimeve;
- f) hetues, prokuror ose ndihmësprokuror, gjyqtar apo ndihmësgjyqtar në procese politike;
- g) denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset gjyqësore politike.

Neni 5 Konflikti i interesit

Asnjë person, që ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë së funksioneve, sipas nenit 4 të këtij ligji, nuk mund të marrë pjesë në çfarëdolloj pozicioni në Autoritetin e Kontrollit të Figurave, si dhe nuk mund të jetë pjesë në trupa gjyqësore që marrin në shqyrtim këtë ligj ose çështje që lidhen me zbatimin e tij.

KREU II AUTORITETI I KONTROLLIT TË FIGURËS

Neni 6 Statusi dhe përbërja e Autoritetit

1. Për zbatimin e këtij ligji krijohet Autoriteti i Kontrollit të Figurës (Autoriteti).
2. Autoriteti organizohet dhe funksionon në mënyrë të pavarur, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në rregulloren e funksionimit të tij.
3. Autoriteti është organ i përhershëm mbikëqyrjeje dhe kontrolli të pastërtisë morale të figurave të funksionarëve publikë.
4. Autoriteti përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët propozohen si më poshtë:
 - a) dy përfaqësues të shumicës parlamentare;
 - b) dy përfaqësues të pakicës parlamentare;
 - c) kryetari me konsensus.
5. Anëtarët e Autoritetit miratohen nga Kuvendi i Shqipërisë. Në rast se vendi i një apo më shumë anëtarëve mbetet vakant për mungesë propozimesh ose për pamundësi zgjedhjeje, sipas pikës 4 të këtij neni, Kuvendi emëron anëtarin përkatës midis të paktën 2 kandidaturave të propozuara nga shoqëria civile.
6. Kryetari dhe anëtarët e Autoritetit përfitojnë pagën sipas tabelës përkatëse të pagave të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar.

Neni 7 Kushtet për t’u zgjedhur anëtar i Autoritetit

Anëtari i Autoritetit të Kontrollit të Figurave duhet të plotësojë këto kushte:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë arsimin e lartë juridik;
- c) të ketë vjetërsi pune jo më pak se 5 vjet;
- ç) të mos jetë i dënuar penalisht;
- d) të mos jetë shkarkuar nga detyra ose të mos ketë marrë masë disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës;
- dh) të ketë figurë të pastër morale, sipas kriterëve të këtij ligji.

Neni 8

Vetëdeklarimi i pastërtisë morale

Çdo kandidat për anëtar, përpara emërimit, duhet të bëjë një deklaratë për pastërtinë e figurës së tij, lidhur me papajtueshmërinë e funksioneve, siç përcaktohet në nenin 4 të këtij ligji.

Neni 9

Verifikimi i pastërtisë morale të kandidatit për anëtar

1. Çdo kandidat për anëtar i Autoritetit, i propozuar sipas nenit 6 të këtij ligji, i nënshtrohet procedurës së verifikimit të pastërtisë së figurës, sipas këtij ligji.
2. Ky verifikim kryhet nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit të propozimit nga Kuvendi.
3. Rezultatet e verifikimit të anëtarëve të Autoritetit bëhen publike.

Neni 10

Fillimi i detyrës nga anëtarët e Autoritetit

1. Anëtarët e Autoritetit fillojnë ushtrimin e detyrës brenda 5 ditëve nga miratimi i tyre prej Kuvendit.
2. Në mbledhjen e parë të tij, Autoriteti, nën drejtimin e kryetarit, zgjedh zëvendës -kryetarin.

Neni 11

Mbarimi i mandatit të anëtarit të Autoritetit

1. Mandati i anëtarit të Autoritetit është 5 vjet.
2. Mandati i anëtarit mbaron para afatit në rastet kur:
 - a) jep dorëheqjen;
 - b) vdes;
 - c) dënohet penalisht me vendim të formës së prerë;
 - ç) deklarohet i paaftë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - d) ushtron detyrën në kundërshtim me rregullat e konfidencialitetit të procedurave të verifikimit;
 - dh) ushtron detyrën me shkelje të përsëritura dhe të pajustificuara të rregullave procedurale që rregullojnë funksionimin e Autoritetit;
 - e) kryen veprime që cenojnë rëndë integritetin e tij.
3. Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Autoritetit.

4. Kuvendi i Shqipërisë, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit për deklarimin e mbarimit të mandatit, nis procedurën për zëvendësimin e anëtarit, duke ndjekur procedurën e parashikuar në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 12
Sekretariati i Autoritetit

1. Autoriteti, gjatë veprimtarisë së tij, mbështetet nga sekretariati, rekrutimi i të cilit bëhet nga Autoriteti, mbi baza të aftësisë profesionale dhe morale.

2. Numri i personelit ndihmës dhe buxheti i Autoritetit miratohen nga Këshilli i Ministrave.

KREU III
PROCEDURA E VERIFIKIMIT

Neni 13
Nisja e procedurës së verifikimit

Autoriteti fillon procedurën e verifikimit të pastërtisë morale të funksionarëve:

- a) kryesisht, për të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji;
- b) me kërkesë me shkrim të titullarit të institucionit apo organit të emërtesës së tij, për funksionarin publik;
- c) me kërkesë të vetë subjektit, kur ai kandidon në mënyrë të pavarur në një proces zgjedhor.

Neni 14
Detyrimi për njoftim për emërimet apo zgjedhjet e reja

1. Drejtuesi i çdo institucioni depoziton tek Autoriteti, brenda 10 ditëve, njoftimin për kandidatët për emërimet në një nga funksionet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji. Akti i emërimit bëhet vetëm pas marrjes së dëshmisë së verifikimit të figurës së zyrtarit nga Autoriteti.

2. Në rastin e të zgjedhurve në Kuvend, në organet e qeverisjes vendore apo në organe të tjera përfaqësuese, kandidatët që konkurrojnë i nënshtrohen verifikimit të figurës së zyrtarit përpara regjistrimit si kandidat në procesin përkatës zgjedhor. Ky njoftim bëhet nga kandidati ose propozuesit e tij.

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk e regjistron kandidatin në rast se ky nuk paraqet dëshminë e verifikimit.

Neni 15
Thirrja e mbledhjes për procedurën e verifikimit

Kryetari i Autoritetit ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, thërret mbledhjen për procedurën e verifikimit brenda 3 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për verifikim nga subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji.

Neni 16 **Rregulla për mbledhjen e Autoritetit**

1. Autoriteti kryen procedurat e verifikimit të pastërtisë morale të figurave nën drejtimin e kryetarit të tij dhe, në mungesë të tij, nga zëvendëskryetari.

2. Për çdo kërkesë për fillimin e procedurës së verifikimit ose për çdo rast të marrë në proces verifikimi kryesisht, Autoriteti hap një dosje të posaçme, në të cilën depozitohen:

- a) kërkesa;
- b) çdo akt dokumentues i veprimtarisë verifikuese;
- c) çdo akt i llojit dokument i marrë në këtë proces.

3. Mbledhja e Autoritetit është e vlefshme, kur në të marrin pjesë të paktën 4 anëtarë.

4. Në çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili kontrollohet për saktësi nga kryetari dhe, në mungesë të tij, nga zëvendëskryetari. Në përfundim të mbledhjes, ky procesverbal nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në të.

5. Në çdo rast, procedura e verifikimit duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për verifikim ose nga data e fillimit kryesisht të procedurës së verifikimit.

Neni 17 **Papajtueshmëria dhe konflikti i interesave**

1. Në fillim të mbledhjes për verifikimin e figurës së çdo funksionari, anëtari i Autoritetit nënshkruan një deklaratë për mungesën e papajtueshmërisë ose të konfliktit të interesit midis tij dhe subjektit nën verifikim.

2. Çdo anëtar i Autoritetit ka detyrimin të paraqesë në mbledhje çdo rrethanë papajtueshmërie apo konflikti interesash që ndonjë anëtar tjetër i Autoritetit ka me subjektin nën verifikim.

3. Anëtari i Autoritetit është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e verifikimit të figurës së funksionarit, në çdo rast që ekzistojnë shkaqe të rëndësishme të papajtueshmërisë apo konfliktit të interesave midis tij dhe subjektit nën verifikim, të tilla që ndikojnë qëndrimin e tij në procedurën e verifikimit. Dorëheqja shqyrtohet dhe pranohet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Autoritetit.

4. Në rastin kur anëtari i Autoritetit, ndonëse ka detyrimin, nuk heq dorë nga pjesëmarrja, përjashtimi i tij vendoset nga mbledhja e Autoritetit, pasi është dëgjuar paraprakisht anëtari. Në këtë rast njoftohet Kuvendi.

Neni 18 **Marrja e të dhënave**

1. Autoriteti, në funksion të përmbushjes së detyrave të ngarkuara me këtë ligj, kërkon t'i vihen në dispozicion të gjitha materialet arkivore, duke përfshirë edhe dokumentacionet e ish-Partisë së Punës të Shqipërisë, nga të cilat mund të merren të

dhëna për veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit dhe të personave të veçantë, që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji.

2. Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ Shtetëror, Ministria e Mbrojtjes, gjykatat dhe prokuroritë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave apo çdo institucion tjetër shtetëror detyrohen të dërgojnë pranë Autoritetit, brenda 20 ditëve nga marrja e kërkesës, të gjitha materialet arkivore të kërkuara nga Autoriteti.

Neni 19

Votimi

1. Çdo anëtar ka detyrimin e votimit pro ose kundër, si dhe detyrimin për të motivuar votën e dhënë. Nuk lejohet abstenimi.

2. Vota e anëtarit në pakicë dhe arsyet e këtij votimi shënohen në procesverbal.

3. Dëshmia e verifikimit për subjektin e verifikuar lëshohet si e pajtueshme kur kanë votuar pro të paktën 3 anëtarë të Autoritetit.

4. Brenda dy ditëve nga mbledhja, kryetari lëshon dëshminë që pasqyron rezultatin e procedurës së verifikimit të pastërtisë morale të funksionarit.

Neni 20

Rezultatet përfundimtare të procedurës së verifikimit

1. Në përfundim të procedurës së verifikimit, Autoriteti:

a) Kur rezulton se subjekti i verifikuar është i papërfshirë në veprimtaritë e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, vendos për lëshimin e dëshmisë së pastër të figurës morale. Kjo dëshmi plotësohet sipas formularëve të aneksit “A” dhe “A/1” bashkëlidhur këtij ligji dhe nënshkruhet nga kryetari apo, në mungesë të tij, nga zëvendëskryetari. Dëshmia i komunikohet kërkuarit të procedurës së verifikimit, si dhe subjektit të verifikuar.

b) Kur rezulton se subjekti i verifikuar është i përfshirë në veprimtaritë e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, vendos të lëshojë dëshminë e verifikimit të figurës morale, sipas formularit të aneksit “B/1” bashkëlidhur këtij ligji. Kjo dëshmi, e nënshkruar nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga zëvendëskryetari, i njoftohet subjektit të verifikuar si material konfidencial. Pas marrjes së dëshmisë, sipas kësaj shkronje, subjekti i verifikuar ka të drejtë të njihet me aktet e përfshira në dosjen e tij pranë Autoritetit nëpërmjet nënshkrimit të formularit për mbrojtje të informacionit të klasifikuar.

2. Kur zyrtari nuk është dakord me rezultatin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, ai ka të drejtën të paraqesë pretendime me shkrim dhe dokumente provuese për çështjen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit.

3. Komisioni shqyrton pretendimet dhe dokumentet e subjektit dhe, brenda 10 ditëve nga paraqitja e tyre, vendos:

a) të njoftojë subjektin kërkuar brenda 3 ditëve për rrëzimin e pretendimeve të tij dhe të lëshojë dëshminë e verifikimit, sipas formularit “B”; ose

b) të lëshojë dëshminë, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 21

Vlera e dëshmisë së verifikimit

Dëshmia e verifikimit, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 20 të këtij ligji, ka fuqi të plotë provuese mbi faktin e pastërtisë së figurës së çdo funksionari publik të zgjedhur apo të emëruar.

Neni 22

Ankimi gjyqësor

1. Subjekti i verifikuar mund të ankimojë dëshminë e verifikimit, sipas shkronjës “b” pika 1 të nenit 20 të këtij ligji, në gjykatën e rrethit gjyqësor.

2. Me kërkesë të subjektit verifikues, gjykata vendos zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura.

3. Kundër vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor subjekti i verifikuar mund të ankohet në gjykatën e apelit brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile. Subjekti i verifikuar mund të ushtrojë rekurs në Gjykatën e Lartë brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 23

Pasojat e dëshmisë në rastin e personave që do të kryejnë një funksion publik

1. Kërkuesi i procedurës ose vetë subjekti i verifikuar, menjëherë pas marrjes së dëshmisë së verifikimit, të lëshuar sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 20 të këtij ligji, e paraqet për depozitim atë në institucionin, pranë të cilit do të fillojë të kryejë funksionin publik ose pranë organit që bën regjistrimin e kandidatëve për proces zgjedhor.

2. Kërkuesi i procedurës, menjëherë pas marrjes së dëshmisë së verifikimit, të lëshuar sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 20 të këtij ligji, thërret subjektin e verifikuar dhe i njofton atij skualifikimin nga vazhdimi i mëtejshëm i procedurës së emërimit ose zgjedhjes, për shkak të padenjësisë së figurës së tij.

3. Kur subjekti i verifikuar deklaron se ka bërë ankim gjyqësor dhe paraqet kopje të aktit të ankimit, procedura e pikës 2 të këtij neni nuk pezullohet derisa vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë.

Neni 24

Pasojat e dëshmisë në rastin e personave në detyrë

1. Kërkuesi i procedurës së verifikimit, menjëherë pas marrjes së dëshmisë së verifikimit, të lëshuar sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 20 të këtij ligji, e depoziton atë në dosjen individuale të personelit.

2. Kërkuesi i procedurës së verifikimit, brenda 3 ditëve nga lëshimi i dëshmisë së verifikimit, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 20 të këtij ligji, depoziton dëshminë në dosjen individuale të personelit dhe njofton subjektin e verifikuar për zhvillimin e një seance të mbyllur informuese brenda 3 ditëve. Në këtë seancë marrin pjesë dy persona të caktuar nga titullari i institucionit ose organi i emërtesës. Gjatë zhvillimit të kësaj seance mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit. Subjekti i verifikuar, nëse e kërkon, pajiset me një kopje të procesverbalit.

3. Kur subjekti i verifikuar deklaron se ka ankimuar procedurën e verifikimit të zhvilluar nga Autoriteti dhe paraqet kopje të ankimit të tij, seanca informuese shtyhet për t’u zhvilluar menjëherë pas marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor.

4. Në rastet e tjera, kur subjekti i verifikuar në përfundim të seancës deklaron ose depoziton dorëheqjen e menjëhershme nga detyra, akti i dorëheqjes arkivohet në dosjen personale të subjektit dhe materiali verifikues (dëshmia e verifikimit dhe procesverbali i seancës informuese) mbetet konfidencial.

5. Kur subjekti i verifikuar deklaron se nuk dëshiron të japë dorëheqjen nga funksioni, atëherë, brenda 10 ditëve nga seanca informuese, mbi bazën e dëshmisë së verifikimit, përfundojnë marrëdhëniet e tij të punës me motivacionin “padenjësi e figurës së funksionarit”.

Neni 25

Transparenca me publikun

1. Autoriteti krijon një regjistër elektronik për të gjitha rastet e verifikuara dhe publikon në faqen e vet zyrtare informacion për numrin e rasteve të verifikuara. Ky informacion përditësohet çdo javë.

2. Autoriteti bën publike në faqen zyrtare identitetin e të gjithë zyrtarëve të kualifikuar si të papajtueshëm për të vazhduar detyrën, për të cilët nuk është zhvilluar procedura e skualifikimit, sipas nenit 23 të këtij ligji, apo nuk ka përfunduar marrëdhënia e punës, sipas nenit 24 të këtij ligji.

Neni 26

E drejta për t'u njohur me dosjen personale

1. Çdo shtetas shqiptar ka të drejtë të njihet me të dhëna personale, në lidhje me atë që përmbajnë dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Për njohjen e këtyre të dhënave shtetasi paraqet kërkesë me shkrim në Autoritetin Shtetëror. Autoriteti, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, është i detyruar të kthejë përgjigje negative nëse nuk ka të dhëna ose, nëse ka të dhëna, të sigurojë mundësinë që shtetasi të njihet me to. Në çdo rast shtetasi njihet vetëm me të dhënat personale të tij dhe i ndalohet të njihet me të dhënat apo emrat e personave të tretë që mund të përmbajë dosja e tij.

3. Rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Funksionimit të Autoritetit.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 27

Fondi arkivor

Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Autoritetit i vihen në dispozicion dublikatat e dokumenteve dhe fondi arkivor i komisionit të ngritur me ligjin nr.8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”.

Neni 28

Verifikimi i figurës së zyrtarëve në detyrë

Autoriteti, sipas radhës së përparësisë së përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji, brenda 6 muajve nga fillimi i funksionimit të tij, përfundon verifikimin e pastërtisë së figurës së çdo funksionari.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29

Afati i veprimtarisë së Autoritetit

- 1. Veprimtaria e Autoritetit, sipas këtij ligji, vazhdon deri më 31 dhjetor 2014.**
- 2. Kuvendi, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton Rregulloren e Funksionimit të Autoritetit. Pjesë e kësaj rregulloreje është edhe mënyra e ndarjes së përgjegjësive dhe e komunikimit ndërmjet Autoritetit dhe sekretariatit teknik të tij.**

Neni 30

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

(STEMA)
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONTROLLIT TË FIGURËS

D Ë S H M I

PËR VERIFIKIMIN E FIGURËS

Nr. _____ prot, datë _____

Autoriteti i Kontrollit të Figurës, në mbështetje të ligjit nr.10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”, pasi zhvilloi procedurën e verifikimit të pastërtisë së figurës, sipas kreut III të këtij ligji, deklaron:

Z./Znj. _____

nuk ka papajtueshmëri me funksionet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

Kjo dëshmi ka fuqi provuese mbi faktin e pastërtisë së figurës, në kuptim të nenit 20 pika 1 shkronja “a” të ligjit nr.10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”.

Kjo kopje e dëshmisë i lëshohet:

Kërkuesit _____
(institucioni, organi ku është zgjedhur, subjekti elektoral)

Adresa: _____

KRYETARI

(STEMA)
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONTROLLIT TE FIGURËS

D Ë S H M I

PËR VERIFIKIMIN E FIGURËS

Nr. _____ prot, datë _____

Autoriteti i Kontrollit të Figurës, në mbështetje të ligjit nr.10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”, pasi zhvilloi procedurën e verifikimit të pastërtisë së figurës, sipas kreut III të këtij ligji, deklaron:

Z./Znj. _____

nuk ka papajtueshmëri me funksionet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

Kjo dëshmi ka fuqi provuese mbi faktin e pastërtisë së figurës, në kuptim të nenit 20 pika 1 shkronja “a” të ligjit nr.10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”.

Kjo kopje e dëshmisë i lëshohet:

Subjektit të verifikuar _____

Adresa: _____

KRYETARI

(STEMA)
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONTROLLIT TË FIGURËS

D Ë S H M I

PËR VERIFIKIMIN E FIGURËS

Nr. _____ prot, datë _____

Autoriteti i Kontrollit të Figurës, në mbështetje të ligjit nr.10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”, pasi zhvilloi procedurën e verifikimit të pastërtisë së figurës, sipas kreut III të këtij ligji, deklaron:

Z./Znj. _____

ka papajtueshmëri me funksionet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

Kjo dëshmi ka fuqi provuese mbi faktin e pastërtisë së figurës, në kuptim të nenit 20 pika 1 shkronja “b”, si dhe të nenit 21 të ligjit nr.10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”.

Kjo kopje e dëshmisë i lëshohet:

- a) Kërkuesit _____
(Institucionit, organit që e ka zgjedhur, subjektit elektoral)

Adresa: _____

- b) Subjektit të verifikuar

Adresa: _____

Subjekti i verifikuar ka të drejtë të bëjë ankim kundër kësaj dëshmie verifikimi në gjykatën e apelit, sipas nenit 22 të këtij ligji.

KRYETARI

(STEMA)
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONTROLLIT TË FIGURËS

KONFIDENCIAL

D Ë S H M I
PËR VERIFIKIMIN E FIGURËS

Nr. _____ Prot, datë _____

Autoriteti i Kontrollit të Figurës, në mbështetje të ligjit nr.10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”, pasi zhvilloi procedurën e verifikimit të pastërtisë së figurës, sipas kreut III të këtij ligji, deklaron:

z./znj. _____

ka papajtueshmëri me funksionet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

Kjo dëshmi ka fuqi provuese mbi faktin e pastërtisë së figurës, në kuptim të nenit 20 pika 1 shkronja “b”, si dhe të nenit 21 të ligjit “Për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”.

Kjo kopje e dëshmisë i lëshohet:

Subjektit të verifikuar _____

Adresa: _____

Subjekti i verifikuar ka të drejtë të njihet me aktet e përfshira në dosjen e tij dhe të paraqesë pretendime brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit (neni 20 pika 2).

KRYETARI

LIGJ
Nr.10 047, datë 24.12.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9109, DATË 17.7.2003
“PËR PROFESIONIN E AVOKATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

- a) Në pikën 1, fjala “dy” zëvendësohet me fjalën “një”.
- b) Pika 3 shfuqizohet.

Neni 2

Pikat 5 e 8 të nenit 33 shfuqizohen.

Neni 3

Në nenin 34 pika 2, pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:
“f) kopje të vulës së avokatit ose zyrës së avokatisë. Vula duhet të jetë unike dhe duhet të përmbaje titullin “Avokat” dhe identitetin e avokatit ose të zyrës së avokatisë. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë përcakton formën, përmbajtjen, procedurën e përgatitjes dhe të shpërndarjes së tyre.”.

Neni 4

Titulli i kreut VIII bëhet “ANKIMET DHE PROCEDURAT DISIPLINORE”

Neni 5

Neni 37 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 37

1. Ankesat/kërkesat ndaj çdo sjelljeje ose veprimi të avokatit i drejtohen kryetarit të dhomës së avokatisë. Kryetari i dhomës së avokatisë ia përcjell ankesën/kërkesën komisionit të verifikimit të ankimit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë brenda 5 ditëve kalendarike nga data e dorëzimit.

2. Ankesat/kërkesat kundër avokatit mund të paraqiten nga:

- a) çdo person që mbrohet, përfaqësohet ose ndihmohet juridikisht prej tij;**
- b) çdo person i tretë, që pretendon se është dëmtuar nga sjellja apo veprimet e avokatit;**
- c) organet drejtuese të dhomave të avokatisë;**
- ç) gjyqtarët dhe prokurorët;**
- d) Ministri i Drejtësisë;**
- dh) çdo organ tjetër shtetëror, i parashikuar me ligj.”.**

Neni 6

Neni 38 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 38

Avokati i nënshtrohet procedimit disiplinor kur:

- a) ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e avokatit dhe me legjislacionin tatimor;**
- b) ka vepruar në kundërshtim me rregullat e parashikuara në Kodin e Etikës së Avokatit dhe me rregullat e tjera të përcaktuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe dhomat e avokatisë.”.**

Neni 7

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 39

1. Për shqyrtimin e kërkesave/ankesave për procedim disiplinor ndaj avokatëve krijohet komisioni i verifikimit të ankimit i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, me avokatë të zgjedhur me short nga lista e përfaqësuesve, me këtë përbërje:

- a) 3 përfaqësues nga Dhoma e Avokatisë, Tiranë;**
- b) 1 përfaqësues, secila, nga dhomat e tjera të avokatisë.**

2. Për shqyrtimin e ankesës/kërkesës për procedim disiplinor ndaj një avokati të caktuar, komisioni i verifikimit të ankimit i Dhomës Kombëtare të Avokatisë zgjedh nënkomisionin e verifikimit të ankimit, i cili ka në përbërje:

- a) kryetarin e komisionit të verifikimit të ankimit, në cilësinë e kryetarit të këtij nënkomisioni;**
- b) dy avokatë të zgjedhur me short nga anëtarët e komisionit të verifikimit të ankimit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe një avokat, që përfaqëson dhomën e avokatisë nga ka ardhur ankimi, në cilësinë e anëtarëve.**

Kryetari i komisionit të verifikimit të ankimit zgjidhet nga Dhoma Kombëtare e

Avokatisë.

Rregullat e hollësishme për procedurën e zgjedhjes dhe të funksionimit të komisionit të verifikimit të ankimit e për zgjedhjen e kryetarit të këtij komisioni përcaktohen në rregulloren e zgjedhjes dhe të funksionimit të komisionit të verifikimit të ankimit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.”.

Neni 8

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40

1. Procedimi disiplinor përbëhet nga fazat e verifikimit, të refuzimit apo të kalimit në gjykim të kërkesës/ankesës dhe të gjykimit.

Procedimi disiplinor fillon me paraqitjen e kërkesës/ankesës nga subjektet e përcaktuara në nenin 37 të këtij ligji.

2. Kryetari i komisionit të verifikimit të ankimit, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës/ankesës, cakton përbërjen e nënkomisionit të verifikimit të ankimit.

3. Avokati, ndaj të cilit është paraqitur ankesa/kërkesa, duhet të paraqesë, me shkrim, pretendimet e tij për ankesën/kërkesën brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

Mosparaqitja e pretendimeve nga avokati para nënkomisionit të verifikimit të ankimit nuk përbën shkak për mosvazhdimin e procedimit disiplinor.

4. Afatet procedurale të verifikimit të ankesës/kërkesës fillojnë nga data e mbërritjes së saj në komisionin e verifikimit të ankimit. Ky komision merr vendim brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankesës/kërkesës.

Për çështje, të cilat kërkojnë hetime të posaçme e të specializuara, ky afat mund të zgjatet edhe 30 ditë të tjera.”.

Neni 9

Pas nenit 40 shtohen nenet 40/1 e 40/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 40/1

1. Nënkomisioni i verifikimit të ankimit, pasi bën verifikimet e nevojshme, dëgjon pretendimet e palëve dhe, sipas rastit, vendos fillimin e procedimit disiplinor kundër avokatit, ose refuzimin e fillimit të procedimit.

2. Vendimi i nënkomisionit të verifikimit të ankimit për refuzimin e ankimit mund të ankimohet në komitetin disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë brenda 10 ditëve nga subjekti që ka paraqitur ankesën/kërkesën. Vendimi i komitetit disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë është i paankimueshëm nga subjekti që paraqet ankesën/kërkesën.

3. Kur nënkomisioni i verifikimit të ankimit e kalon çështjen për gjykim, vendimi është i pakundërshtueshëm, nga pikëpamja procedurale, në komitetin disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Kur çështja kalon për gjykim, kryetari i komisionit të verifikimit të ankimit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë e përfaqëson çështjen përpara komitetit disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në cilësinë e palës.

Neni 40/2

1. Nënkomisioni i verifikimit të ankimit merr vendim për rrëzimin e kërkesës/ankesës ose kalimin e saj për gjykim para komitetit disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe e shpall atë brenda 10 ditëve.

2. Nënkomisioni i verifikimit të ankimit, për marrjen e vendimeve, vendos me shumicë votash. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, çështja kalon për gjykim.

3. Nënkomisioni i verifikimit të ankimit duhet t'u dërgojë palëve kopje të vendimit të shpallur prej tij.”.

Neni 10

Neni 41 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 41

1. Masat disiplinore jepen sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

2. Palët në procedimin disiplinor kanë të drejtë të paraqiten dhe të japin shpjegime në seancë, vetë ose nëpërmjet mbrojtjes e përfaqësimit me avokat. Nëse njëra ose të dyja palët nuk paraqiten në seancë, pa motive të arsyeshme, komiteti disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë shqyrton çështjen dhe merr vendim në mungesë të tyre.

3. Gjatë procedurës ankimore, komisioni disiplinor mund të dëgjojë shpjegime nga palët dhe dëshmitarët e tyre.

4. Shpjegimet e palëve dhe dëshmitë në seancë mund të jepen me gojë ose me shkrim.

5. Komiteti disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë pranon dëshmitë dhe dokumentet e paraqitura para tij, me cilësinë e provës dhe i çmon ato sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi.

6. Masat disiplinore jepen brenda 3 muajve nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 5 vjet nga çasti i kryerjes së saj.”.

Neni 11

Neni 42 shfuqizohet.

Neni 12

Në nenin 43 bëhen këto ndryshime:

a) Në fjalinë e parë, fjalët “komisioni disiplinor i Dhomës së Avokatisë” zëvendësohen me fjalët “komisioni disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë”.

b) Në shkronjën “ç”, fjalët “i propozon komitetit disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë” hiqen.

Neni 13

Neni 44 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 44

1. Kur komiteti disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në përfundim të shqyrtimit të ankesës/kërkesës, e deklaron avokatin fajtor, përveç masave të parashikuara në nenin 43 të këtij ligji, mund t'i kërkojë avokatit që:

- a) të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zgjidhjen e problemit në fjalë;**
- b) t'i kompensojë dëmin e shkaktuar kërkuarit/ankuesit apo palëve të tjera të dëmtuara nga veprimet e tij, në masën që çmohet e drejtë nga rrethanat, që rezultojnë nga shqyrtimi i ankesës/kërkesës.**

2. Komiteti disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë urdhëron avokatin e deklaruar fajtor të paguajë shpenzimet e palëve dhe të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, për përballimin e çështjes disiplinore në fjalë.”.

Neni 14

Neni 45 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 45

1. Komiteti disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë gjykon çështjen brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të materialit për ankim. Ky komitet, me kërkesë të njëres prej palëve, mund të shtyjë, për shkaqe të përligjura, afatin e gjykimit, por jo më shumë se 30 ditë nga data e caktimit të gjykimit. Vendimi i këtij komiteti duhet të jetë i arsyetuar dhe u njoftohet palëve brenda 3 ditëve nga përfundimi i gjykimit.

2. Vendimi i komitetit disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë mund të ankimohet nga pala ankuese/kërkuuese ose avokati në gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e mosmarrëveshjes brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Ankimi bëhet edhe në rast se vendimi nuk merret brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.”.

Neni 15

Pas nenit 45 shtohet neni 45/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 45/1

1. Për veprimtarinë e mësipërme, Dhoma Kombëtare e Avokatisë miraton tarifat e shpërblimit.

2. Rregulla të hollësishme për shpenzimet përkatëse përcaktohen në rregulloren e komitetit disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.”.

Neni 16

Neni 46 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 46

Dhoma Kombëtare e Avokatisë regjistron vendimet disiplinore dhe njofton Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm për këto vendime.”.

Neni 17

Në nenin 48, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë përcaktojnë me vendim të përbashkët shpenzimet për regjistrimin e kandidatëve për avokatë, organizimin e provimit dhe shpalljen e rezultateve të tij, të cilat duhet të jenë të barabarta me koston që duhet të përballohet në këtë rast, si dhe tarifën e marrjes së licencës për avokatët.”.

Neni 18

Nenet 47, 49 e 50 shfuqizohen.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.6004, datë 13.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.10 048, datë 24.12.2008

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 7, DATË 15.12.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9836, DATË 26.11.2007 “PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2008”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.7, datë 15.12.2008, i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar”.

Shpallur me dekreten nr.6005, datë 13.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 049, datë 24.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7811, DATË 12.4.1994
“PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.782, DATË 22.2.1994
“PËR SISTEMIN FISKAL NË SEKTORIN E HIDROKARBUREVE
(KËRKIM-PRODHIM)””

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7811, datë 12.4.1994 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.782, datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)””, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 1, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kontraktuesi detyrohet të paguajë, në çdo vit fiskal, tatimin mbi fitimin e realizuar në atë vit fiskal, si dhe taksën e rentës minerare për hidrokarburete që nxjerr nga nëntoka.

Tatimi mbi fitimin tërhiqet në para, siç parashikohet në çdo marrëveshje hidrokarburesh.

Taksa për rentën minerare paguhet në sasinë dhe sipas procedurave, që përcaktohen në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”. ”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6006, datë 13.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 050, datë 24.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8990, DATË 23.1.2003
“PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS”

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 15, pika 3 shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6007, datë 13.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 15.1.2009
Doli nga shtypi më 15.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 24 lekë